

SHËRBIMET ESENCIALE PËR SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPRODHUES DHE HIV TË GRAVE DHE GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA GJATË PANDEMISË ME COVID-19

Mund, 2020



A Member Association of



SHËRBIMET ESENCIALE PËR SHËNDE TIN SEKSUAL DHE RIPODHUES DHE HIV TË GRAVE DHE GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA GJATË PANDEMISË ME COVID-19



Nevojat e grave dhe grupeve të marginalizuara lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues, duke përfshirë edhe HIV, në Maqedoni nuk duhet në asnjë çast të lihen anësh, e veçanërisht jo gjatë krizës së pandemisë me COVID-19.

Të drejtat dhe zgjedhja e grave dhe çifteve lidhur me shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues duhet të respektohen tërësisht, pa dallim të krizës së krijuar të shkaktuar nga virusi korona. Te shtatzënat dhe foshnjat e sapolindura ndodhin një varg ndryshimesh fizike dhe ndryshime në zhvillimin e fetusit, që i bënë mjaft të rrezikuar nga infektimet virale respiratorë siç është COVID-19. Prandaj shtatzënat, pa dallim nëse janë të dyshuara ose të infektuara me COVID-19, nuk guxon t'u vështirësohet qasja deri te mbështetja e domosdoshme mjekësore. Kjo e përfshinë edhe kujdesin e vazhdueshëm antenatal, ruajtjen e shëndetit mendor dhe mbështetjen psiko-sociale.

Zvogëlimi i shërbimeve për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe HIV, negativisht do të reflektohet mbi cilësinë e jetës së pacientëve, të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor ose marrin mbrojtje shëndetësore pa pagesë, e veçanërisht gratë, vajzat, komunitetet e marginalizuara dhe grupet sociale të rrezikuara. Qasja e zvogëluar deri te shërbimet për planifikim të familjes e rritë rrezikun nga shtatzënia e paplanifikuar. Mos qasja ose mbyllja e spitaleve të gjinekologjisë mund të sjell deri te rritja e vdekshmërisë së lehonave, siç po ndodh në disa regjione në botë të cilat janë të goditura nga pandemia.




Mbyllja e shkollave shpesh sjell deri te aktiviteti i rritur seksual te të rinjtë, ndërsa nëse ekziston mungesë e prezervativëve dhe kontracepsionit modern, rriten edhe mundësitë për shtatzëni adoleshente, që më tej do sillte deri te braktisja e sistemit arsimor nga ana e vajzave dhe negativisht do të ndikojë mbi zhvillimin dhe jetën e tyre të mëtejshme.

Gejët, personat që injektojnë drogë dhe punëtorët seksuale janë veçanërisht të ekspozuar ndaj diskriminimit dhe dhunës gjatë krizës, e me këtë edhe janë në rrezik më të madh nga infektimi nga HIV dhe infektime tjera seksualisht të transmetueshme.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ka për obligim t'i garantojë shërbimet themelore dhe që shpëtojnë jetë për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe HIV në kushte të krizës humanitare – ashtu siç janë definuar nga ana e një numri të madh të agjencive dhe organizatave shëndetësore ndërkombëtare, agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe shkencëtarët.

Gjatë riorganizimit të sistemit shëndetësor dhe masat për mbrojtjen e popullatës, Qeveria duhet t'i sigurojë grave dhe komuniteteve të marginalizuara qasje të vazhdueshme deri te shërbimet esenciale për shëndetin riprodhues dhe HIV, pa dallim që për momentin kapacitetet e sistemit shëndetësor janë orientuar drejt përbalimit me krizën me COVID-19. Po ashtu, buxheti për financimin e shërbimeve për shëndet riprodhues dhe seksual nuk guxon të zvogëlohen ose të ndalohen. Organizatat qytetare të cilat sigurojnë shërbime në terren për HIV dhe për shëndetin riprodhues për grupet e marginalizuara duhet të vazhdojnë me punë, me qëllim që të garantohet vazhdimësia në komunikim dhe në mbështetjen e komuniteteve për shërbimet për të cilat kanë ata nevojë, duke përfshirë edhe distribuimin e prezervativëve dhe lubrikantëve për parandalimin e shtatzënisë së paplanifikuar, HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme.

The background is a solid green color. It features several stylized virus particles, each with a circular head and several thin, radiating spikes. A large, white dotted circle is centered on the page, framing the text. The text is white and bold, arranged in six lines.

**PAKOJA ESENCIALE
E SHËRBIMEVE PËR
SHËNDETIN SEKSUAL DHE
RIPRODHUES DHE HIV NË
KUSHTE TË PANDEMISË
ME COVID-19**

PARANDALIMINGA HIV DHE INFEKTIMET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME (IST)

- › Këshillim dhe diagnostifikimii IST dhe HIV
- › Trajtimi për IST
- › Distribrimi i prezervativëve dhe lubrikantëve pa pagesë
- › Shërbime për zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave dhe substancave (pajisje sterile për injektim të drogës, terapi substitucione)
- › Terapi anti-virusale për personat të cilët jetojnë me HIV
- › Mbështetje psiko-sociale për personat të cilët jetojnë me HIV
- › PPE (Profilaksia post-ekspozuese) për viktimat e dhunës seksuale dhe punëtorëve shëndetësor
- › Me profilaksi trimoxazole për infektive oportuniste për personat të cilët jetojnë me HIV

PARANDALIMI I SHTATZËNISË SË PAPANIFIKUAR

- › Trajtimi mjekësor i viktimave të dhunës seksuale
- › Mbështetje psiko-sociale dhe sigurimi për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës së bazuar në gjini, dhunës seksuale dhe dhunës familjare

PAKOJA ESENCIALE E SHËRBIMEVE PËR SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPRODHUES DHE HIV NË KUSHTE TË PANDEMISË ME COVID-19

PARANDALIMI NGA DHUNA SEKSUALE DHE DHUNA E BAZUAR NË GJINI

- › Këshillime për kontracepsionin
- › Vendosja e spirales
- › Pranimi i kontracepsionit oral
- › Pranimi i kontracepsionit urgjent
- › Distribrimi i prezervativëve

ULJA E VDEKSHMËRISË MATERNALE DHE FOSHNJAVE TË SAPOLINDURA

- › Kujdesi urgjent antenatal gjithëpërfshirës dhe kujdesi për foshnjat e sapolindura
- › Lindja dhe kujdesi themelor antenatal dhe kujdesi për foshnjën e sapolindur
- › Konsultimi për lindje të sigurt dhe udhëzim
- › Mbrojtja antenatale
- › Transport 24-orësh për rastet urgjente deri në spitale
- › Aborti dhe kujdesi për abortin (me kërkesë personale, raste të komplikuara)

HERA – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim

Franklin Ruzvelt 51a/26, 1000 Shkup

tel: 02/3290-395

fax: 02/2556-002

www.hera.org.mk

hera@hera.org.mk

